



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. R-227/1 prot.

Tiranë, më 25.11.2022

U R D H Ë R

Nr. 631, Datë 25.11.2022

**“PËR
MARRJEN NË DORËZIM TË REGJISTRAVE DHE AKTEVE NOTERIALE TË ISH-
NOTERES RUDINA HOXHAJ”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7 të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, Urdhrit nr.167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”,

KONSTATOJ:

Me Urdhrit nr. 557 datë 17.10.2022, të Ministrit të Drejtësisë, është vendosur heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit, noteres Rudina Hoxhaj, referuar nenit 21, pika 1, gërma “a”, e Ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar.

Në këto kushte, lind nevoja për ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të regjistrave dhe akteve noteriale, të ish-noteres znj. Rudina Hoxhaj, me qëllim mbarëvajtjen e punës dhe mospengimin e shtetasve për pajisjen me akte noteriale të cilat ndodhen në arkivën e ish noterit, si dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës së thatë dhe të njomë të ish-noteres.

Për sa më sipër, bazuar në Ligjin nr. 110/2018 “Për noterinë”, në pikën 1 dhe 2 të Urdhrit nr. 167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”, si dhe pas administrimit të shkresës nr. R-207/5 prot., datë 04.11.2022 dhe të email datë 17.11.2022, të Dhomës Kombëtare të Noterisë,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të arkivës noteriale të ish - noteres znj. Rudina Hoxhaj, i përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a.) Znj. Erisa Sulçe, specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b.) Znj. Sidorela Gjonpalaj, specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - c.) Znj. Violeta Sulkaj, përfaqësuese nga Dega Vendore e Noterisë Tiranë;

d.) Znj. Gentiana Brati, përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterisë.

2. Ish-noteri, personi i autorizuar prej tij përmes prokurës së posaçme ose personi që ka në ruajtje arkivën i dorëzon regjistrat, aktet noteriale dhe vulat përkatëse Komisionit të ngritur në pikën 1 të këtij urdhri, në ditën dhe orën që është caktuar në marrjen e njoftimit përkatës.

3. Komisioni për marrjen në dorëzim të arkivës, merr në dorëzim me procesverbal të nënshkruar nga të gjithë anëtarët dhe noteri, regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit dhe vulat përkatëse.

4. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, anëtarët e komisionit të caktuar në pikën 1, të këtij urdhri, të verifikojnë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojnë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.

5. Arkiva t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noterës, së Degës Vendore të Noterisë Tiranë **znj. Xhoana Omari**, pas verifikimit nga ana e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të arkivit, se noterja plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryerjen sa më të shpejtë e cilësor të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

6. Komisioni i ngritur në zbatim të këtij urdhri kryen dorëzimin e regjistrave dhe akteve noterial noterës **znj. Xhoana Omari**, si dhe kryen asgjësimin e vulës së thatë dhe vulës së njomë, të ish-noterës Rudina Hoxhaj.

7. Ngarkohet Drejtoria TIK në Ministrinë e Drejtësisë për të çaktivizuar ish-noteren, si përdoruese të sistemit RNSH, si dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë nga sistemi NISA.

8. Ngarkohet Sektori Arkiv – Protokollit për njoftimin e këtij urdhri personave përgjegjës, si dhe ish-noterës Rudina Hoxhaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ULSI MANJA

